

VENDIM
Nr. 1, datë 12.3.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN PËR SHITJEN ME PAKICË TË
PRODUKTEVE PËR DATAT 12–15.3.2022

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të neneve 21/3 dhe 21/5 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan për shitjen me pakicë të produkteve për datat 12–15.3.2022, si më poshtë:

- 217 lekë/litri për gazoilin;
- 217 lekë/litri për benzinën; dhe
- 93 lekë/litri për gazin e lëngshëm të naftës.

2. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Znj. Delina Ibrahimaj	kryetar;
Znj. Belinda Balluku	anëtar;
Z. Ceno Klosi	anëtar;
Z. Genti Gazheli	anëtar;
Z. Niko Lera	anëtar;
Z. Ilia Gjermani	anëtar;
Z. Enea Karakaçi	anëtar;
Z. Sezar Beqaj	anëtar;
Z. Artur Llogoni	anëtar;
Z. Gerian Kuqi	anëtar;
Z. Agron Bulku	anëtar;
Z. Saimir Krasniqi	anëtar.